



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 737/18
Datë/Datum. 05.09.2018

PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH Nr. 737/18

PANELI SHQYRTUES i emëruar nga kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues dhe z. Goran Milenkovic – anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2017, të dt:20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, / Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)/ të datës: 01.08.2018, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, përkitazi me operatorin ekonomik "Astraplan shpk" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i kulmit te kazermës se FSK-se ne Mitrovicë", me nr. prok: 217-18-1552-521, më dt: 29.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET, si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) /Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)/ e dt:01.08.2018, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "Astraplan shpk - Prishtinë lidhur me procedurën e prokurimit me titull "Renovimi i kulmit të kazermës se FSK-së në Mitrovicë" me nr. prok: 217-18-1552-521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)/.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues / MFSK / me dt:26.07.2018, ka parashtruar kërkesë tek OSHP-ja që konform kompetencave që të veprohet konform nenit 99.2 të LPP-së dhe të bëj diskualifikimin e Operatorit Ekonomik "Astraplan shpk" – Prishtinë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 98.2, të LPP-së me datë: 10.08.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtuese, për të përgatitur një kronologji në lidhje me këtë kërkesë.

Ekspertja shqyrtuese me dt:01.08.2018 ka dorëzuar kronologjinë ku ka sqaruar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datë: 01 gusht 2018, nga autoriteti kontraktues Ministria e Forcës së Sigurisë, ka pranuar kërkesë për diskualifikim të OE "ASTRAPLAN SHPK" ku kanë theksuar: operatori ekonomik "ASTRAPLAN SHPK", ka qenë i rekomanduar për dhënie të kontratës për projektin "Renovimi i kulmit te kuzhinës në kazermën e FSK-së në Mitrovicë me numër te prokurimit: 217/18/1552-521 dhe numër të brendshëm: 21700/18/011/521, edhe pse janë krijuar te gjitha kushtet për nënshkrim te kontratës sepse kanë kaluar afatet kohore për ankese OE në fjalë nuk ka shprehur gatishmëri për nënshkrim te kontratës. AK duke u bazuar në LPP-në ka anuluar këtë aktivitetit te prokurimit, andaj duke u bazuar ne dispozitat e LPP-së kërkojnë nga OSHP-ja, marrjen e masave ndaj këtij operatori ekonomik konform nenit 99 të LPP-së dhe të diskualifikohet operatori ekonomik në fjalë për një periudhe kohore prej një viti për pjesëmarrje në aktivitete të prarimit.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se në bazë te nenit 99.2 të LPP-së, marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet te prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet te prokurimit ka prezantuar dokumente të falsifikuar, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave te rreme ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, në te cilin thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Eksperti shqyrtues konsideron se në rastin konkret autoriteti kontraktues në bazë te dispozitave ligjore dhe akteve nën ligjore për prokurim publik, ka masa tjera që mund ti merre vet AK-ja, për rastin në fjalë ndaj operatorit ekonomik për te cilin ka parashtruar kërkesë në OSHP për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së.

Në seancën dëgjimore e cila është mbajtur me dt:29.08.2018, kanë marr pjesë paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues si dhe përfaqësuesi i AK-së, ndërsa përfaqësuesi i OE "Astraplan" shpk - Prishtinë, edhe pse është ftuar me ftesë të rregullt.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese znj.Hoti deklaroj: AK-MFSK me 01.08.2018 ka kërkuar nga OSHP të marr masa ndaj OE Astraplan në pajtim me nenin 99.2 të LPP. Në kërkesë të AK thuhet se OE Astraplan ka qenë i rekomanduar për dhënie të kontratës për projektin renovimi i kulmit të kuzhinës në kazermën e FSK në Mitrovicë me numër prokuimi 217/18/1552/521. Sipas AK edhe pse janë krijuar kushtet

për nënshkrim të kontratës OE në fjalë nuk është ofruar për nënshkrim të kësaj kontrate. Nisur nga kjo arsye AK kërkon nga OSHP marrjen e masave për diskualifikim të këtij OE.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-MFSK z.Maxhuni deklaroj: OE Astraplan ka qenë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, gjatë procesit të vlerësimit OE në fjalë i ka plotësuar minimumin e kërkesave të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Mbi bazën e kësaj neve kemi kërkuar prej OE konform njoftimit për kontratë një vërtetim nga ATK dhe vërtetimin e gjykatës, përkundër se ka pas një kopje në ofertën e tij sipas procedurave kërkohet të sjellën para nënshkrimit për kontratë dhe ka qenë e periudhës 14.02.2018. OE sipas arsytimit të tij personi përgjegjës në kompani ka qenë jashtë vendit dhe nuk ka pas mundësi ti përgjigjet kërkesës së AK. Ne kemi bërë njoftimin për dhënie të kontratës dhe pas kalimit të gjitha afateve kohore ku nuk ka pas ankesa në këtë aktivitet, OE në fund ka sjell deklarata nga ATK se ka obligime të pashlyera dhe nuk ka arritur të sistemoj borxhet dhe nuk ka qenë i gatshëm për nënshkrimin e kontratës. Ne kemi shqyrtuar alternativa tjera, mirëpo kofnrom LPP është dashtë të anulohet vendimi për dhënie dhe të anulohet komplet aktiviteti i prokurimit, dhe sipas njoftimit të KRPP nuk ka mundësi të shkohet me OE të dytë në radhë pas njoftimit për dhënie të kontratës. Mbi bazën e kësaj AK ka vendos që ti rekomandoj organeve kompetente që ndaj OE të përgjigje në kohë që të mos na dëmtoj për aktivitetin e prokurimit që kemi zhvilluar procedurat. Andaj i propozojmë OSHP-së që marr një masë ndëshkimore ndaj OE në fjalë, të diskualifikohet nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë për 10 muaj.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE z.Istrefi deklaroj: Sa i përket kërkesës së z.Maxhuni drejtor i prokurimit pranë MFSK, që në start e njoftojmë panelin se është e pabazuar kërkesa, mirëpo mendojmë se është e qëllimshme. AK-MFSK na ka rekomanduar për kontratë pa i plotësuar kërkesat dhe kushtet e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit që e pranoj vet edhe përfaqësuesi i AK. Ne kemi biseduar përmes telefonit me z.Maxhuini dhe e kam njoftuar se kam qenë mbi tri javë jashtë shtetit në udhëtim zyrtar, dhe për këtë dëshmi mund të ofroj pasaportën ku shihen edhe vulat. Përmes telefonit i kam treguar z.Maxhuni se teknikisht dhe fizikisht nuk mund ti sjellim këto dokumente siç parasheh afati ku sipas LPP është 5 ditë nga data kërkesës. AK edhe pse nuk i kemi dorëzuar këto dokumente na ka rekomanduar për kontratë ku pas kërkesës për plotësimin e disa dokumenteve tjera për nënshkrim të kontratës ne kemi kërkuar në ATK vërtetimin e ATK ku për çudi kanë dal disa obligime për cilat nuk kemi ditur, dhe po atë vërtetim dhe një emali falënderues ja kam dërguar z.Maxhuni dhe kemi thënë se nëse nuk jemi në kundërshtim me ligjin të nënshkruajmë kontratë me AK ne do vijmë të nënshkruajmë mirëpo dyshojmë se bëjmë shkelje ligjore. Prapë në bisedë me z.Maxhuni edhe vet ka thënë se nuk mund të nënshkruajmë kontratë derisa kemi obligime në ATK. Kërkojmë nga paneli shqyrtues të refuzoj kërkesën e AK-së MFSK si të pabazuar.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, deklaramit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë nuk ka ofruar dëshmi se operatori ekonomik "Astraplan shpk" - Prishtinë ka ofruar ndonjë dokument të falsifikuar apo të dhëna të rreme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues në mungesë të dëshmive dhe argumenteve se operatori ekonomik "Astraplan shpk" - Prishtinë ka ofruar ndonjë dokument të falsifikuar apo të dhëna të rreme, vjen në përfundim se kërkesa e AK-së, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të operatorit ekonomik OE "Astraplan shpk" - Prishtinë është e pabazuar dhe e pa mbështetur në fakte dhe argumente konkrete dhe se kërkesa e autoritetit kontraktues nuk hynë në kuadër të kompetencave të OSHP-së, të parashikuara në nenin 99.2 të LPP.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z.Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – MFSK

1x1 OE "Astraplan" shpk - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së